



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI KOMBËTAR I UJIT

Nr. 714 prot.

Tiranë, më 18.6 2019

V E N D I M

Nr. 1, datë 12.06 2019

PËR

**MIRATIMIN E LEJES “PËR NDËRTIMIN E STRUKTURAVE  
ANKORUESE”, ME OBJEKT “NDËRTIMI I IMPIANTIT  
FOTOVOLTAIK LUNDRUES DHE VEPRAVE NDIHMËSE TË TIJ”**

Në mbështetje të shkronjës “b” të pikës 2, të nenit 41, të ligjit nr.111/2012, “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore”, i ndryshuar dhe të VKM-së nr.416, datë 13.5.2015 “Për miratimin e kushteve të posaçme, dokumenteve shoqëruese, afatit të vlefshmërisë, formularëve të aplikimit për autorizim dhe leje, procedurave të shqyrtimit dhe vendimmarrjes, si dhe formateve të autorizimit dhe lejes për përdorim të burimeve ujore”, me propozimin e Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore, Këshilli Kombëtar i Ujit

V E N D O S I:

1. Miratimin e lejes “Për ndërtimin e strukturave ankoruese”, subjektit “STATKRAFT RENEWABLES ALBANIA” sh.p.k., me objekt “Ndërtimi i impiantit fotovoltaik lundrues dhe veprave ndihmëse të tij”.
2. Ngarkohet Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI

ERION BRÇE

